



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1473/11 Prot.

Tiranë, më 03.06 2025

V E N D I M

Nr. 65 datë 03.06 2025

**“MBI
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR
KONKURS, REGJISTRIMIT TË FITUESVE, PËR CIKLIN E PARË, TË DYTË,
TË STUDIMEVE DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR TË DY CIKLET E
STUDIMEVE, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS PËR VITIN
AKADEMIK 2025-2026”**

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH pika 3/ç të nenit 3, nenit 6, pika 28, 29, 30, nenit 38, nenit 83, nenit 85, të Statutit të UST, të Rregullores së UST, të VKM nr. 288 datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IPAL, në një program të ciklit të parë të studimeve ose në një program të integruar të studimeve profesionale me kohë të plotë", të VKM nr. 778, dt. 26.12.2018; VKM nr. 779 dt. 26.12.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr. 269, dt.29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" të ndryshuar", VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike", të Urdhërit të MASR me nr. 495, datë 11.10.2019 "Për hapjen e njësive kryesore 'Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit' në Universitetin e Sporteve të Tiranës", Urdhërit të MAS nr. 245 datë 22.07.2020 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Shkenca të Rehabilitimit" në Universitetin e Sporteve të Tiranës", të Urdhërit Ministres nr. 355 datë 17.09.2021 "Për hapjen e Programit të studimit të ciklit të dytë "Master profesional në Trajner i Përgatitjes Fizike, në Universitetin e Sporteve të Tiranës", të Urdhërit të MAS nr. 446 datë 14.08.2023 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në Rehabilitim Fizioterapeutik në Universitetin e Sporteve të Tiranës", të Vendimit Qarkullues të Senatit Akademik nr. 52 datë 11.04.2025 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit,

për vitin akademik 2025-2026", të Vendimit Qarkullues të BA nr. 19 datë 11.04.2025 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2025-2026", Senati Akademik në mbledhjen e datës 03.06.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit në konkursin praktik të aplikantëve (FSHL, FVFR) dhe tarifat e regjistrimit të fituesve (FSHL, FVFR, FSHR) për ciklin e parë të studimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelave bashkëngjitur.
2. Tarifat e regjistrimit në konkurimin praktik të aplikantëve, tarifat e aplikimit dhe tarifa e regjistrimit të fituesve të kandidatëve nga trojet, me statusin e jetimit, kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian në programet e ciklit të parë, transferim studimesh dhe program të dytë studimit, për vitin akademik 2025-2026, janë të njëjta me tarifat, për ciklin e parë të studimeve.
3. Tarifat e aplikimit të kandidatëve, kandidatëve për transferim studimesh e të tjerë dhe tarifa e regjistrimit të fituesve për ciklin e dytë të studimit (program i parë/ program i dytë), për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelave bashkëngjitur.
4. Të miratojë tarifën e shkollimit për ciklin e parë të studimeve "Bachelor", për të gjithë programet e studimit, për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelave bashkëngjitur.
5. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
6. Studenti që i mbetet vetëm provimi i formimit dhe nuk është i detyruar të ndjekë studimet gjatë vitit akademik 2025-2026, duhet të paguajë vetëm tarifën për kreditet e mbetura.
7. Studentët të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik, nga viti 2025-2026 e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit, sipas tabelës bashkëngjitur, ndërsa studentët me mesatare mbi 6 paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit, pjesa tjetër rimbursohet nga fonde grand të buxhetit të shtetit.
8. Studentët që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve dhe rezultojnë me mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës, përjashtohen nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2025-2026.
9. Studentët e pranuar në vitin e parë akademik me notë mesatare vjetore 9(nëntë)- 10(dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlllogaritur si mesatare të notave të të gjithë viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore sipas listës së sjellë nga QSHA, përjashtohen nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2025-2026.

10. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin transferohen dhe ndjekin studimet.

11. Kandidatët/aplikantët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe, në këtë rast, aplikantët fitues përballojnë koston e plotë të studimeve, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

12. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të parë apo në një program të dytë studimi të ciklit të parë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë vjetore të shkollimit, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në këto programe studimi, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit. Ministria e Arsimit, dhe Sportit dërgon për çdo vit listën e studentëve të huaj që përfitojnë nga marrëveshjet zyrtare shtetërore.

13. Të miratojë tarifën e shkollimit për studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelave bashkangjitur dhe e paguajnë tarifën e shkollimit të ndarë në këste.

14. Studentët të cilët nuk kanë përfunduar programin përkatës të studimit të ciklit të dytë apo nuk kanë shlyer të gjithë provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij dhe konsiderohen mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë tarifën për kredit të parashikuar sipas këtij vendimi.

15. Studentët e ciklit të dytë sipas shtresave në nevojë, studentët që vijnë nga cikli i parë i studimeve me notën mesatare 9-10 dhe studentët që vazhdojnë studimet në ciklin e dytë në vitin pas të parit dhe kanë shlyer të gjithë detyrimet akademike për vitin akademik. paraardhës me mesatare të vitit paraardhës 9-10, përjashtohen 50% nga tarifa e shkollimit.

16. Studentët e ciklit të parë dhe të dytë që plotësojnë kriteret për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit plotësisht apo 50% të saj duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës brenda afateve të përcaktuara që do të nxirret në www.ust.edu.al dhe lista përfundimtare e tyre miratohet nga Bordi i Administrimit.

17. Tarifat e regjistrimit në konkursin praktik, aplikimit për ciklin e dytë dhe të regjistrimit të fituesve të bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës www.ust.edu.al, pas miratimit nga Bordi i Administrimit.

18. Tarifat vjetore të shkollimit për të dy ciklet e studimit të bëhen publikë në faqen zyrtare të Universitetit www.ust.edu.al.

19. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AGRON KASA



Tab. 1

Nr	FAKULTETI	Emërtimi	Tarifa në lekë
1	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve Program i dytë i studimeve)	5,000
2	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e regjistrimit të fituesve(në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve / Program i dytë i studimeve)	2,000
3	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e aplikimit të kandidatëve(në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2,500
4	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e aplikimit të kandidatëve(në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3,000
5	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e regjistrimit të fituesve(në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2,000
6	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	5,000
7	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e regjistrimit të fituesve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	2,000

Tab. 2

Nr	FAKULTETI	Emërtimi	Tarifa në lekë
1	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve Program i dytë i studimeve)	5,000
2	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Tarifa e regjistrimit të fituesve(në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve / Program i dytë i studimeve)	2,000
3	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Tarifa e aplikimit të kandidatëve(në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2,500
4	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Tarifa e aplikimit të kandidatëve(në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3,000
5	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Tarifa e regjistrimit të fituesve(në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2,000
6	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	5,000
7	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Tarifa e regjistrimit të fituesve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	2,000

Tab. 3

Nr	FAKULTETI	Emërtimi	Tarifa në lekë
1	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	Tarifa e regjistrimit të fituesve(në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve / Program i dytë i studimeve)	2,000
2	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	Tarifa e aplikimit të kandidatëve(në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2,500
3	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	Tarifa e aplikimit të kandidatëve(në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3,000
4	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	Tarifa e regjistrimit të fituesve(në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2,000

Tab. 4

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit cikli i parë Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	Tarifa për program të parë studimi (në lekë) për vitin akademik 2025-2026	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	Bachelor	35 000	233 916

Tab. 5

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Profesional	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 60 kredite në lekë për vitin akademik 2025-2026	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik në lekë / 60 kredite në lekë për vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	Trajner i përgatitjes fizike	1083 (65 000)	1250 (75 000)

Tab. 6

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 35 kredite në lekë për vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	Formimi i vazhduar në Psiko Pedagogji	(35 000)

Tab.7

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2025-2026	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	Master në mesuesi "Edukim fizik dhe shëndetësor" në FSHL	1750 (210 000)	2125 (255 000)
2	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	Master Shkencor në Shkencë Sportive	1750 (210 000)	2125 (255 000)

Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit

Tab. 1

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit cikli i parë	Tarifa për program të parë studimi (në lekë) për vitin akademik 2025-2026	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Bachelor Fushat e veprimtarisë fizike të shëndetit dhe të rekrea	35 000	233 916

Tab.2

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Profesional	Tarifa per kredit per program te pare studimi (ne leke)/ 60 kredite ne leke per vitin akademik 2025-2026	Tarifa per kredit per program te dyte studimi (ne leke) per vitin akademik ne leke / 60 kredite ne leke per vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Menaxhim në Sport dhe Turizëm	1250 (75 000)	1520 (91 200)
2	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Aktivitet Fizik dhe Rekreacion-Trainer fitness (FVFR)	1330 (79 800)	1530 (91 800)

Tab.3

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa per kredit per program te pare studimi (ne leke)/ 120 kredite ne leke per vitin akademik 2025-2026	Tarifa per kredit per program te dyte studimi (ne leke)/ 120 kredite ne leke per vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	1750 (210 000)	2125 (255 000)

Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit

Tab. 1

Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit cikli i pare Bachelor	Tarifa për program të parë studimi (në lekë)për vitin akademik 2025-2026	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	Fusha Shkenca të Rehabilitimit	35 000	233 916
Tab.2				
Nr	Fakulteti	Emërtimi i Programit Master Profesional	Tarifa për program të parë studimi (në lekë)për vitin akademik 2025-2026	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2025-2026
1	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport	72,000	87 600